



Pranuar / Dorezuar Prenjelo/Prodato Received/Delivered	01.11.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kohëzina Quantity
SHKMBITIK	6811/2023		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1228/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1228/2023 të datës 02.10.2023, të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë _____ kundër Vendimit me Nr.Prot: 2322 të datës 26.09.2023 të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, në çështjen juridike "Masë disiplinore-largim nga shërbimi civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 01.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.1228/2023 e datës 02.10.2023, e parashtruar nga ankuesi _____.

II.Anulohet Vendimi me Nr.Prot: 2322 i datës 26.09.2023 i Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës.

III.Obligohet Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës, që brenda afatit prej (15) pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të kthejë ankuesin në pozitën e punës sipas Aktit të Emërimit me Nr.Prot: 02/2021 të datës 19.04.2021, më të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, si dhe të bëjë kompensimin e pagave të paralizuar nga data 08.09.2023 të ndaluar sipas Vendimit me Nr. Prot: 2186 të Komisionit Disiplinor, deri në zbatimin e këtij vendimi dhe të bëjë heqjen e masës disiplinore nga dosja personale e ankuesit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar sipas Aktit të Emërimit me Nr. Prot: 02/2021 të datës 19.04.2021 në pozitën *Menaxher i Personelit* në Inspektoratin e Punës, më datë më datë 29.08.2023 është inicuar procedurë disiplinore në Komisionin Disiplinor të Inspektoratit të Punës me arsyetimin se *i njëjti ka propozuar themelimin e Komisionit për procedurën e lëvizjes brenda kategorisë për Udhëheqës të Divizionit për Koordinim Rajonale në Gjilan në kundërshtim me nenin 46 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil, po ashtu gjatë procedurës së lëvizjes brenda kategorisë për pozitë Inspektor i Punës në Rajonin e Prizrenit ka vepruar kundërligjshëm duke shkelur nenin 44 dhe 45 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil kjo për faktin se në këtë konkurs kishte aplikuar z. me masë disiplinore aktive dhe të pashuar, ky i fundit edhe është përzgjedhur nga komisioni vlerësues për pozitën në fjalë. Për rastin e parë kemi pranuar parashtresë për ndërhyrje në procedurë dhe është kërkuar nga z. të anulohet procedurën në fjalë ndërsa i njëjti nuk e anulon. Për rastin e dytë kryetari i komisionit të vlerësimit ka njoftuar rreth masës disiplinore aktive të z. dhe është kërkuar opinionimi ligjor nga Departamenti për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore dhe sipas këtij opinionimi z. i është kërkuar që të anulohet këtë konkurs mirëpo i njëjti nuk e anulon konkursin në fjalë. Për shkak mos respektimit të kërkesave të ZKA i njëjtit ka bërë shkelje të rënda disiplinore.*

Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës fillimisht më datë 08.09.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. Prot: 2186 përmes të cilit ka bërë pezullimin e marrëdhënies së punës së ankuesit, ndërsa përmes Vendimit me Nr. Prot: 2322 të datës 26.09.2023 i shqipton masën disiplinore *largim nga shërbimi civil.*

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. Prot: 2322/2023 të datës 26.09.2023 të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, më datë 02.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6305/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e regjistruar nën shenjën A.nr.1228/2023, për shkak të vlerësimit të gabuar të gjendjes faktike, shkelje esenciale të procedurës dhe aplikim i gabuar i ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Inspektoratin e Punës. Ndërsa më datë 06.10.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me provat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6305/2023 e datës 02.10.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. Prot: 2322/2023 të datës 26.09.2023 të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës; Parashtresë për ndërhyrje

në procedurë e datës 14.07.2023; Opinionin ligjor i datës 24.07.2023 nga [redacted] Kërkesën nga BNJ e ankuesit për V.Zh e datës 01.09.2023; Emailin e datës 03.02.2023 nga ankuesi për Vendimin me Nr. 140/2023 të datës 28.09.2023 të Agjencisë për Informim dhe Privatësi; Kërkesë për pezullim të aktit e datës 11.09.2023 nga ankuesi për [redacted]; Kërkesë e datës 08.09.2023 nga ankuesi për [redacted]; Emailin e datës 12.09.2023 nga ankuesi për [redacted]; Propozim Vendimin për formimin e komisioni të lëvizjes brenda kategorisë për Udhëheqës të Divizionit për Koordinim Rajonal në Gjilan; Emailin e datës 12.07.2023 për ndryshime të disa anëtarëve të komisionit; Emailin e datës 10.04.2023 nga ankuesi Emailin e datës 06.09.2023 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 31.07.2023, 01.08.2023, 11.08.2023 nga ankuesi lidhur me opinionin ligjor; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 04.10.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 06.10.2023; Akt Emërimit me Nr. Prot:02/2021 të datës 19.04.2021; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 24.06.2022 për pozitën Menaxher i Personelit; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 29.08.2023; Emailin e datës 20.09.2023 nga [redacted] për seancë të Komisionit Disiplinor; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesin të datës 06.02.2023 dhe 28.01.2022; Vendimin me Nr. Port: 2182 të datës 07.09.2023 për plotësimin e vendimit për përbërjen e Komisionit Disiplinor; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 25.09.2023; Konkursin me Nr. Reference RN00011780 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal-Gjilan; Vendimin me Nr. Prot: 1758 të datës 13.07.2023 për formimin e Komisioni për Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal-Gjilan; Kërkesën për anulim të konkursit për ankuesin e datës 24.07.2023; Konkursin me Nr. Reference RN00011720 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Inspektor i Punës në Prizren; Njoftim për verifikim paraprak me Nr. prot:87/2023 të datës 29.06.2023; Njoftim për kandidatin fitues me Nr.Prot: 155/2023 për Inspektor të Punës në Prizren; Vendimin me Nr. 84/2023 të lëshuar nga Menaxheri i Personelit; Aplikacionin e [redacted]; Vërtetimin e datës 20.06.2023 të Menaxherit të Personelit të Inspektoratit të Punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar në mënyrë të hollësishme të gjitha shkresat e lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë, konstatoi se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse*:

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.Prot: 2322/2023 të datës 26.09.2023 të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se vendimi i atakuar karakterizohet me vlerësim të gabuar të gjendjes faktike, shkelje esenciale të procedurës dhe aplikim të gabuar të ligjit material, duke theksuar se procedura disiplinore është inicuar në kundërshtim me procedurën ligjore ngase nuk ka asnjë element të shkeljes disiplinore, sepse për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal ne Gjilan një kandidatë ka ndërhyrë në proces dhe e cila nuk ka pasur të drejtë konkurimi këtë e ka vërtetuar edhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me vendimin e tij, po ashtu Komisioni për lëvizje brenda kategorisë për këtë pozitë është propozuar në mënyrë ligjore dhe i njëjti komision është emëruar dhe nuk është përgjegjësi e Menaxherit të Burimeve Njerëzore emërimi i komisionit; Sa i përket konkursit për Inspektor të Punës në Rajonin e Prizrenit kandidati z. [redacted] është përfshirë në listën e verifikimit paraprak ngase masa disiplinore e shqiptuar ndaj tij nuk është bërë ende e plotfuqishme sepse është parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe

këtu kam vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërsa edhe pse i njëjti është kandidat fitues nuk është emëruar pasi është pritur vendimmarrja lidhur me këtë çështje; Më janë shkelur të drejtat e mia të garantuara ngase në momentin që jam pezulluar më është bllokuar edhe emaili zyrtar dhe nuk kam pasur më qasje; Pretendimi se kam bërë shkelje që nuk kam anuluar konkursin për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Koordinimit Rajonal në Gjilan dhe Inspektor i Punës në Rajonin e Prizrenit janë pretendime të pabazuara, sepse roli i Menaxherit të Burimeve Njerëzore është i kufizuar vetëm në fazën e vlerësimit të aplikacioneve.

Ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, i cili pretendon se inicimi i procedurës disiplinore konkretisht shqiptimit i masës disiplinore për shkak të mos anulimit të konkursit për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal në Gjilan, Kolegji i Këshillit, në bazë të provave materiale të lëndës, konstaton se Inspektorati i Punës më datë 05.06.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr. Referencës: RN00011780 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Koordinimin Rajonale në Gjilan dhe mbi bazë të përfundimit të afatit të aplikimit përgatitjes së listës së verifikimit paraprak, ankuesi në cilësinë e Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore bazuar në nenin 46 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin në Karrierë të Shërbimit Civil më datë 13.07.2023 ka propozuar themelimin e Kromosnit për Lëvizje Brenda Kategorisë me nëpunës civil të nivelit më të lartë se pozita që rekrutohet dhe anëtarë të tjerë duke përfshirë edhe zëvendësuesit e tyre. Bazuar në Vendimin me Nr. Port: 1758 të datës 13.07.2023 është formuar Komisioni për Lëvizje Brenda Kategorisë me pozita përkatëse si parashihet me dispozitat e cekura si më lartë dhe se ky vendim nuk është nxjerr nga ankuesi por nga zyrtari kryesor administrativ i këtij institucioni. Më datë 24.07.2023 një palë ka parashtruar një kërkesë për ndërhyrje në këtë procedurë duke theksuar se Komisioni për Lëvizje Brenda Kategorisë është themeluar në kundërshtim me nenin 46 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin në Karrierë të Shërbimit Civil duke theksuar se në komision është dashur të jenë dy Koordinator e jo dy Inspektor të Punës, ndërsa kjo kandidate më datë 28.08.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit A.nr.1120/2023 të datës 22.09.2023 ka hedhë poshtë ankesën e datës 28.08.2023 të ankueses duke konstatuar se kjo ankuese nuk ka qenë kandidate në këtë procedurë për shkak që ka qenë nëpunëse e një kategorie më të ulët po ashtu e njëjta meqë nuk ka qenë pjesë e procedurës andaj edhe nuk ka pas të drejtë të kontestoj një procedurë të tillë ngase nuk i është cenuar asnjë e drejtë nga marrëdhënia e punës që e ushtron sipas aktemrimit në fuqi.

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse rasti i ankuesit ka ardhur si rezultat i formimit të Komisionit për Lëvizje Brenda Kategorisë për pozitën e lartcekur, atëherë Kolegji i Këshillit duke u bazuar në Vendimin me Nr.Prot: 1758 të datës 13.07.2023 për formimin e këtij komisioni, konstaton se sipas nenit 46 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin në Karrierë të Shërbimit Civil, është përcaktuar se: "2.KVLBK përbëhet nga: 2.1. dy (2) anëtar nëpunës civil të specializuar në fushën përkatëse për të cilin zhvillohet konkurrin; 2.2. dy (2) anëtar, nëpunës civil të nivelit më të lartë se pozita e lirë që rekrutohet për lëvizjen brenda kategorisë të institucionit përkatës ose institucionit tjetër të shërbimit civil, njëri nga ta mbikëqyrës i Drejtpërdrejtë; 2.3. një (1) përfaqësues i Njesisë së Burimeve Njerëzore të

institucionit", kështu që marr parasysh këtë dispozitë, Kolegji konstaton se norma ka përcaktuar që vetëm dy (2) anëtar të komisionit duhet të jenë nëpunës civil të nivelit më të lartë se pozita e lirë që rekrutohet, ndërsa për pozitat e anëtarëve të tjerë nuk është përcaktuar që duhet të jenë pozitat të nivelit më të lartë apo të nivelit të njëjtë por vetëm është përcaktuar se dy anëtar duhet të jetë të specializuar në fushën përkatëse që zhvillohet rekrutimi dhe një anëtar i njësisë së burimeve njerëzore, ndërsa propozimi për formimin e Komisionit për Lëvizje Brenda Kategorisë e që në vetë do të kishte anëtar me pozita të Inspektorit të Punës nuk është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura pasi që ky standard është vendosur sipas Vendimit A.nr.766/2023 të datës 30.06.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes të cilit është vendosur për konkursin për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Udhëheqës i Divizionit të TI-së dhe Shërbime Logjistike pranë Inspektoratit të Punës, kështu që pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit se inicimi i procedurës për rastin e përfshirjes në procedurë të kandidatit z. [] në konkursi për Inspektor të Punës në Rajonin e Prizrenit është bërë në mënyrë të kundërligjshme, Kolegji i Këshillit konstaton se Inspektorati i Punës më datë 30.05.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr. Referencës: RN00011720 për lëvizje brenda kategorisë për pozitë Inspektor i Punës në Prizren, ndërsa në këtë procedurë ka aplikuar edhe kandidati [] i cili aktualisht është në pozitën Inspektor i Punës në Gjakovë dhe në bazë të provave materiale i njëjti është përfshirë në listën e verifikimit paraprak sipas vendimit me Nr. 84/2023 të cilin e ka nxjerr ankuesi si Menaxher i Personelit, ndërsa në bazë të njoftimit për kandidatin fitues me Nr. Prot: 155/2023 ka dalur si kandidat fitues me gjithsej 93.4 pikë. Me qëllim të shqyrtimit të drejtë të kësaj çështje juridike administrative kemi kërkuar dosjen e këtij kandidati dhe në bazë të shqyrtimit të saj gjegjësisht sipas Vërtetimit të lëshuar nga ankuesi në cilësinë e Menaxherit të Personelit thuhet se *në dosjen e zyrtarit ka masë "vërejtje me shkrim" mirëpo bazuar në legjislacionin aktual në fuqi masa nuk është e plotfuqishme për arsye se zyrtari në fjalë ka ushtruar drejtën e ankesës, si rrjedhojë marr parasysh dispozitat ligjore për pranim në shërbimin civil po ashtu edhe marr parasysh kërkesat e konkursit për të aplikuar në pozitë të lëvizjes brenda kategorisë kandidatët duhet të mos jenë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende, në këtë rast edhe kandidati [] ka një masë disiplinore të shqiptuar mirëpo i njëjti për këtë ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe ankesa tashmë është vendosur nga këshilli përmes vendimit me numër A.nr.1145/2023, me që rast të njëjtit i është aprovuar ankesa dhe i është anuluar masa disiplinore "Vërejtje" me numër Nr.657/2023 e datës 22.08.2023 e shqiptuar nga Udhëheqësja e Divizionit dhe Koordinimit në Rajonin e Gjakovës ndaj ankuesit sipas kësaj ankese N.A, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas nenit 144 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar se: "1.Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar; 1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa; 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues 1.4. njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji, apo 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës", e nëse marrim për bazë edhe nenin 130 paragrafi 1 të këtij ligji, është përcaktuar se: "1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën", atëherë masa disiplinore e shqiptuar ndaj këtij kandidati nuk*

është e plotfuqishme dhe nuk mund të prodhojë pasoja juridike deri në vendosjen përfundimtare me akt administrativ, ndërsa në rastin konkretë tashmë është definuar kjo çështje me vendim meritor me që rast ky kandidatë i zgjedhur sipas këtij konkursi nuk ka në fuqi masën disiplinore që i është shqiptuar nga Udhëheqësja e Divizionit dhe Koordinimit në Rajonin e Gjakovës

Kolegji i Këshillit, bazuar në këtë gjendje faktike, konstaton se ankuesi me rastin e lëshimit të vërtetimit për këtë kandidat, Vendimin me Nr. 84/2023 për përfshirje në listën e verifikimit paraprak të këtij kandidati për këtë pozitë, nuk ka cenuar asnjë parim të ligjshmërisë, respektivisht i njëjti ka vepruar në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura dhe gjendjes faktike, për më tepër kandidati ka rezultuar si kandidat fitues në këtë procedurë mirëpo i njëjti ende nuk është emëruar në këtë pozitë ngase si rezultat i ankesës ndaj kësaj mase disiplinore të shqiptuar ishte duke u pritur vendimi përfundimtar i këshillit(e që tashmë është vendosur siq e potencuam më lartë përmes vendimit A.nr.1145/2023) lidhur me masën disiplinore dhe varësisht nga kjo edhe vepohet kështu ka njoftuar sipas emailit të datës 02.08.2023.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, i cili pretendon se në këtë procedurë më janë shkelur të drejtat e mia të garantuara ngase në momentin që jam pezulluar më është bllokuar edhe emaili zyrtar dhe nuk kam pasur më qasje, Kolegji i Këshillit, në bazë të provave materiale të lëndës, konstaton se ankuesit i është ndaluar qasja në emailin zyrtar ngase është pezulluar nga puna po ashtu mos dhënia e informacioneve lidhur me këtë procedurë ndaj ankuesit është vërtetuar edhe në procesverbalin e Komisionit Disiplinor të 25.09.2023, kështu që është vepruar në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 1 dhe 2, nenin 92 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 48 paragrafi 6 ndërlidhur me nenin 24 paragrafi 1 të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se inicimi i procedurës disiplinore me arsyetimin që nuk janë zbatuar urdhrat për anulimin e konkursit për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Koordinimit Rajonal në Gjiilan dhe Inspektor i Punës në Rajonin e Prizrenit, Kolegji i Këshillit, konstaton se ligjdhënësi konkretisht me Ligjin e aplikuar në këtë periudhë Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin në Karrierë të Shërbimit Civil, Njesisë së Burimeve Njerëzore në këtë rast pozitës së ankuesit i janë dhënë kompetenca për të ndërmarr veprimet ligjore për shpalljen e procedurës, përgatitjen e listës së verifikimit paraprak, shqyrtimin e ankesave ndaj verifikimit paraprak, propozimin për themelimin e komisioneve për konkurset respektive, mirëpo sipas procedurave ligjore të zbatueshme nuk është përcaktuar që Menaxheri i Burimeve Njerëzore mund të anuloj një procedurë e cila i kërkohet, ngase me dispozitat e Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin në Karrierë të Shërbimit Civil janë paraparë rastet kur procedura mund të ndërpritet dhe në këtë rast duhet plotësuar kushtet ligjore, e në rastin konkret për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Koordinimit Rajonal në Gjiilan dhe Inspektor i Punës në Rajonin e Prizrenit nuk janë plotësuar kushtet ligjore për anulim, ngase për të parën ankuesi nuk ka bërë themelimin e Komisionit për Lëvizje Brenda Kategorisë dhe është kompetencë e tij,

ndërsa për rastin e dytë sa i përket kandidatit të përfshirë në fazat e procedurës nuk ka ndonjë shkelje ligjore sepse pala nuk ka pas masë disiplinore në fuqi, kështu që ankuesi përmes emailit të datës 31.07.2023 dhe 01.08.2023 konteston se nuk do të ndër marr asnjë masë për anulimin e konkurseve për shkak që do të bënte shkelje ligjore dhe në këtë rast do të bënte vepër penale, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se me Ligjin e aplikuar në këtë periudhë Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë është detyrim i ekzekutimit të detyrave dhe urdhrave profesionalë dhe refuzimit të urdhrave të paligjshëm, konkretisht me nenin 26 paragrafi 1, 2 dhe 3, i cili përcakton se: "1. Zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit. 2. Nëse zyrtari publik dyshon për paligjshmërinë e urdhrit të mbikëqyrësit, ai nuk e zbaton urdhrin, por informon pa vonesë mbikëqyrësin e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkon konfirmimin me shkrim nga ana e mbikëqyrësit. 3. Zyrtari publik ka detyrimin të zbatojë urdhrin e konfirmuar me shkrim, sipas paragrafit 2 të këtij neni, me përjashtim të rastit kur zbatimi i tij përbën vepër penale".

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se procedura disiplinore ndaj ankuesit është inicuar mbi bazën e një opinionit ligjor të lëshuar nga Departamenti për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore të datës 24.07.2023 dhe mbi bazë të parashtrësës për ndërhyrje në procedurë të datës 24.07.2023 të M.K, kështu që iniciimi i procedurës disiplinore është bërë në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë konkretisht nenin 45 dhe 48, dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ngase pretendimet për shkelje disiplinore të supozuara nga ana e ankuesit janë pretendime të paqëndrueshme dhe të njëjtat nuk kanë mbështetje në faktet e prezantuara nga palët në procedurë, ngase edhe opinionit ligjor mbi bazë të të cilit është inicuar procedura disiplinore është kundërtë dhe i paqartë ngase në një rast siç është rasti i emailit të datës 06.09.2023 të dërguar nga [] për [] thekson se ankesa ka efekt pezullues sipas nenit 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për më tepër opinionit sipas vetë hartuesit të këtij opinionit konstaton se nuk është i karakterit obligues, kështu që pretendimi i ankuesit është i bazuar në këtë kuptim.

Në kuptim të vendosjes meritorë lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, dhe gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit me Nr.Prot: 2322 të datës 26.09.2023 të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkitazi me rregullimin e procedurës dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, gjegjësisht Kolegji mori për bazë:nenin 45 më të cilin nenë ishte përcaktuar se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit", nenin 46, i cili trajton shkeljet disiplinore ku përcaktonte se: "shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta, Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërmbyllja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbylljen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasojë të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbylljen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat

jepen për shkak të detyrë; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë” ndërsa “Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar”, nenin 47 paragrafi 1 më të cilin ishte përcaktuar se: “Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”, nenin 50 i cili kishte përcaktuar se: “1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit”.

Duke u bazuar në këto dispozita ligjore, po ashtu duke u bazuar në provat materiale dhe duke u bazuar në konstatimet të elaboruara si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se veprimet e ankuesit nuk përbëjnë shkelje disiplinore, kështu që Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.Prot: 2322 të datës 26.09.2023, nuk ka arritur të konstatoj në mënyrë të drejtë gjendjen faktike, mirëpo konstatimin e ka bërë po thuajse të njëjtë sikurse është parashtruar edhe kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore, si rrjedhojë bazuar si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës, më rastin e nxjerrës së Vendimit me Nr.Prot: 2322 të datës 26.09.2023, ka vepruar në kundërshtim me nenin 45, nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, nenin 48 paragrafi 3, 50 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat të nenit 11, 12, 13 paragrafi 3, 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ndërsa arsyetimi i vendimit është në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimi i ankuesit kundër këtij vendim është i bazuar.

Duke qenë së vendimi i kundërshtuar me ankesë është përfshirë me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale e të cilat e bëjnë të paligjshëm një akt administrativ, Kolegji i Këshillit, vendosi për aprovimin e ankesës dhe anulimin e Vendimit me Nr.Prot: 2322 të datës 26.09.2023 të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, duke obliguar Kryeinspektorin e Inspektoratit të Punës që ankuesin ta kthej në vendin e punës sipas Aktit të Emërimit me Nr. Prot: 02/2021 të datës 19.04.2021, më të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, si dhe të bëjë kompensimin e pagave të porealizuara nga data 08.09.2023 deri në zbatimin e këtij vendimi, si dhe duke bërë heqjen e masës disiplinore nga dosja personale e ankuesit.

Bazuar si më lartë, Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1228/2023, datë 01/11/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.